20151965390

L I GJ
PËR MBROJTJEN E DENONCUESVE

Qëllimi i ligjit

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen denoncimi i mbrojtur, të drejtat e denoncuesve, si dhe veprimi dhe detyrat e institucioneve respektivisht personave juridikë në lidhje me denoncimin e mbrojtur dhe sigurimin e mbrojtjes së denoncuesve.

Domethënia e shprehjeve

Neni 2

(1) Denoncim i mbrojtur në kuptimin e këtij ligji është denoncimi me të cilin në pajtim me ketë ligj bartet dyshimi racional ose kuptimi se është kryer, kryhet ose është e sigurt se do të kryhet veprim i ndëshkueshëm, apo veprim tjetër joligjor ose i palejuar me të cilin shkelet ose cenohet interesi publik.

(2) Denoncues në kuptimin e këtij ligji është personi i kategorive te përcaktuara në paragrafin (3) të këtij neni, i cili me qëllim të mirë kryen denoncimin e mbrojtur në pajtim me këtë ligj.

(3) Kategoritë e personave të cilët në pajtim me këtë ligj mund të paraqiten në cilësi të denoncuesve janë:

- personi i cili ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar ose të caktuar në institucionin respektivisht personin juridik për ku denoncon;
- kandidati për punësim, kandidat për vullnetar ose praktikant në institucion respektivisht person juridik për ku denoncon;
- personi i cili është ose do ka qenë vullnetar ose praktikant në institucion respektivisht person juridik për ku denoncon;
- personi i cili në çfarëdo baze është ose ka qenë i angazhuar për realizimin e punës nga institucioni respektivisht personi juridik për ku denoncon;
- personi i cili në çfarëdo baze është ose ka qenë në marrëdhënie afariste ose marrëdhënie tjetër në bashkëpunim me institucionin respektivisht personin juridik për ku denoncon;
- personi i cili shfrytëzon ose ka shfrytëzuar shërbime në institucionin respektivisht personin juridik në sektorin publik dhe privat për ku denoncon;

(4) Me nocionin interes publik në kuptimin e këtij ligji nënkuptohet mbrojtja e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut dhe të qytetarit të pranuara me të drejtën ndërkombëtare dhe të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, parandalimin e rreziqeve ndaj shëndetit, mbrojtjen dhe sigurinë, mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe natyrës, mbrojtjen e pronës dhe lirisë së tregut dhe sipërmarrësisë, sundimin e të drejtës dhe parandalimin e krimit dhe korrupsionit.

(5) Me nocionin person i afërt nënkuptohen bashkëshorti ose partneri jashtëmartesor, farefisi sipas gjakut në linjë të drejtë, farefis në linjë anësore përfundimisht deri në shkallën e tretë, si dhe farefis sipas krushqisë përfundimisht deri në shkallën e dytë, të adoptuar dhe adoptues dhe person tjetër të cilin personi i mbrojtur e konsideron si person të afërt dhe për të cilin kërkon të mbrohet në pajtim me dispozitat e nenit 8 dhe 9 të këtij ligji.

Denoncimi i mbrojtur

Neni 3

(1) Denoncimi i mbrojtur kryhet si denoncim i mbrojtur i brendshëm, denoncim i mbrojtur i jashtëm ose denoncim i mbrojtur publik, në pajtim me nenet 4,5 dhe 6 të këtij ligji, me qëllim të mirë dhe me dyshim racional në vërtetësinë e informatave në përmbajtjen e kallëzimit në kohën e denoncimit.

(2) Denoncuesi nuk është i obliguar ta dëshmojë qëllimin e mirë dhe vërtetësinë e denoncimit nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Denoncuesit i sigurohet mbrojtje në pajtim me ligjin dhe i garantohet anonimitet dhe besueshmëri deri në shkallë dhe momentin deri kur ai këtë e kërkon.

(4) E drejta e anonimitetit të denoncuesit mund të kufizohet me vendim gjyqësor për të cilin pa prolongim njoftohet denoncuesi.

Denoncimi i mbrojtur i brendshëm

Neni 4

(1) Denoncim të mbrojtur denoncuesi kryen në institucionin, respektivisht personin juridik, për ku ka dyshim ose kuptim se është kryer, kryhet ose do të kryhet ose vepër e ndëshkueshme, ose veprim tjetër joligjor ose i palejuar, me të cilin shkelet ose cenohet interesi publik (në tekstin në vijim: denoncim i mbrojtur i brendshëm).

(2) Denoncimin e brendshëm të mbrojtur denoncuesi e kryen në mënyrë me gojë në procesverbal ose në formë të shkruar te personi i autorizuar nga personi udhëheqës në institucion respektivisht person juridik për ku denoncon (në tekstin në vijim: personi i autorizuar për pranimin e denoncimeve nga denoncuesit).

(3) Në institucionin përkatësisht personin juridik ku nuk ka person të autorizuar për pranim të denoncimeve nga denoncues, denoncimi i brendshëm i mbrojtur bëhet te personi udhëheqës i institucionit përkatësisht personit juridik në mënyrë përkatësisht në formë të përcaktuar me paragrafin (2) të këtij neni.

(4) Personi juridik për pranim të denoncimeve nga denoncues përkatësisht personi udhëheqës në institucionin përkatësisht personin juridik nga paragrafi (3) i këtij neni, është i obliguar:

- të veprojë pas denoncimit nga paragrafi (1) i këtij neni me respektimin e procedurave të përcaktuara me aktin për denoncim të brendshëm,
- t'i mbrojnë të dhënat personale të denoncuesit, përkatësisht të dhënat të cilat mund ta zbulojnë identitetin e denoncuesit i cili kërkon të jetë anonim apo denoncon në mënyrë konfidenciale, në pajtim me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale,
- ta informojë denoncuesin i cili është i njohur për masat e ndërmarra në lidhje me denoncimin pa prolongim, ndërsa më së voni në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të denoncimit.

(5) Denoncimi i brendshëm i mbrojtur në institucionet në sektorin publik rregullohet me akt që me propozim të Komisionit Shtetëror për parandalim të korrupsionit e miraton ministri i Drejtësisë.

(6) Denoncimi i brendshëm i mbrojtur në sektorin privat rregullohet me akt të brendshëm të personit juridik me më së paku 10 persona të punësuar.

(7) Aktet e brendshme nga paragrafët (5) dhe (6) të këtij neni botohen edhe në mënyrë tjetër bëhen të arritshme në mënyrë publike për të gjithë të punësuarit në institucionin, përkatësisht personin juridik.

(8) Udhëzime për miratimin e akteve të brendshme nga paragrafi (6) i këtij neni miraton ministri i Drejtësisë.

Denoncimi i jashtëm i mbrojtur

Neni 5

(1) Denoncim të mbrojtur denoncuesi mund të kryejë edhe me denoncimin te Ministria e Punëve të Brendshme, prokuroria kompetente publike, Komisioni Shtetëror për pengimin e korrupsionit, Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë ose institucione tjera kompetente respektivisht persona juridik, nëse:

- denoncimi nga neni 4 i këtij ligji është i orientuar drejtpërdrejt apo tërthorazi kundër personit udhëheqës në institucion respektivisht person juridik ku denoncon,
- denoncuesi lidhur me denoncimin nuk merr informatë për masat e ndërmarra në afatin e përcaktuar në nenin (4) paragrafi 4 alineja 3 të këtij ligji ose
- nuk janë ndërmarrë masa ose denoncuesi nuk është i kënaqur nga veprimi ose dyshon se nuk do të ndërmerren masa ose se denoncimi nga paragrafi (1) i nenit 4 të këtij ligji do të shkaktojë pasoja të dëmshme për atë ose për personin e tij të afërt (në tekstin e mëtejmë: denoncimi i jashtëm i mbrojtur).

(2) Denoncimin e jashtëm të mbrojtur denoncuesi e kryen me gojë në procesverbal ose me shkrim te personi i autorizuar respektivisht te personi udhëheqës në institucion respektivisht personin juridik ku denoncon.

(3) Organet, institucionet respektivisht personat juridikë te të cilët denoncuesi ka kryer denoncim të jashtëm të mbrojtur janë të obliguar në suaza të kompetencave të veta të veprojnë pas denoncimit nga paragrafi (1) i këtij neni, t'i mbrojnë të dhënat personale të denoncuesit, respektivisht të dhënat të cilat mund ta zbulojnë incidentin e denoncuesit i cili kërkon të jetë anonim ose denoncon në mënyrë konfidenciale, në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale, ndërsa për masat e ndërmarra ta informojnë denoncuesin pa prolongim, e më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të denoncimit.

(4) Denoncimi i jashtëm i mbrojtur rregullohet me akt të cilin e miraton ministri i Drejtësisë.

(5) Nëse organi të cilit i është dorëzuar informata nuk është kompetent të veprojë lidhur me denoncimin do ta përcjellë informatën te organi kompetent në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit dhe për atë njëkohësisht do ta njoftojë denoncuesin.

(6) Organi kompetent nga paragrafi (5) i këtij ligji është i obliguar t'i zbatojë masat për mbrojtje të cilat denoncuesit ia ka siguruar organi të cilit i është kaluar njoftimi.

(7) Organi i autorizuar është i obliguar me kërkesë të denoncuesit t'i japë njoftim për rrjedhën dhe veprimet të cilat janë ndërmarrë në procedurë, si dhe t'i mundësojë denoncuesit që të kryejë këqyrje në shkresat e lëndëve, në pajtim me ligjin.

(8) Organi i autorizuar është i obliguar, pas përfundimit të procedurës ta njoftojë denoncuesin për rezultatin e procedurës nga paragrafi (1) i këtij neni, në pajtim me ligjin.

Denoncimi i mbrojtur publik

Neni 6

(1) Denoncim të mbrojtur publik denoncuesi mund të kryejë me bërjen publike të informatave të qasshme lidhur me kuptimin se është kryer, kryhet ose është e sigurt se do të kryhet vepër e ndëshkueshme me të cilën cenohet ose rrezikohet jeta e denoncuesit dhe personit të afërt të tij, shëndeti i njerëzve, siguria, mjedisi jetësor, dëme me përmasa të mëdha, respektivisht nëse ekziston rrezik i ndërsjellë për asgjësimin e dëshmive.

(2) Denoncuesi i cili do të kryej denoncim me bërjen e informatave të qasshme publike në kundërshtim me këtë nen dhe pa paraqitje paraprake te personi i autorizuar për pranimin e denoncimeve nga denoncuesit respektivisht te institucioni kompetent në pajtim me nenet 4, 5 dhe 6 paragrafi (1) nga ky ligj, nuk ka të drejtë të mbrojtjes e cila sigurohet në pajtim me nenet 8, 9 dhe 10 të këtij ligji.

(3) Denoncuesi kryen denoncim të mbrojtur publik në pajtim me ligjin me bërjen e informatave të qasshme publike është i obliguar ta respektojë prezumimin e pafajësisë së të denoncuarit, si dhe të mos e rrezikojë mbajtjen e procedurës gjyqësore.

Mbrojtja e të dhënave dhe incidentit të denoncimit

Neni 7

(1) Ndalohet zbulimi ose mundësimi i zbulimit të identitetit të denoncuesit, përveç atëherë kur ajo kërkohet me vendim gjyqësor.

(2) Personi i autorizuar për pranimin e denoncimeve nga denoncuesit është i obliguar t'i mbrojë të dhënat për denoncuesin, respektivisht të dhënat në bazë të të cilave mund të zbulohet identiteti i denoncuesit, përveç nëse denoncuesi është pajtuar për zbulimin e atyre të dhënave dhe në pajtim me ligjin me të cilin rregullohet mbrojtja e të dhënave personale.

(3) Çdo person i cili do t'i kuptojë të dhënat nga paragrafi (1) i këtij neni është i obliguar t'i mbrojë ato të dhëna.

(4) Personi i autorizuar për pranimin e denoncimeve nga denoncuesit është i obliguar gjatë pranimit të informatave ta njoftojë denoncuesin se identiteti i tij mund t'i zbulohet organit kompetent, nëse pa zbulimin e identitetit nuk do të ishte e mundur të veprohet para atyre organeve, si dhe ta njoftojë për masat për mbrojtjen e pjesëmarrësit në procedurën penale.

(5) Nëse gjatë procedurës është e domosdoshme të zbulohet identiteti i denoncuesit, personi i autorizuar për pranimin e denoncimeve nga denoncuesit është i obliguar që për atë ta njoftojë denoncuesin, para zbulimit të identitetit.

(6) Të dhënat nga paragrafi (1) i këtij neni nuk guxojnë t'i zbulohen personit për të cilin sugjerohet në informatë.

Sigurimi i mbrojtjes së denoncuesit

Neni 8

(1) Denoncuesit dhe personit të afërt të tij u sigurohet mbrojtje e çfarëdo lloji të shkeljes së të drejtës ose veprimit të dëmshëm ose rrezikut nga paraqitja e veprimeve të dëmshme për shkak të kryerjes së denoncimit të mbrojtur të jashtëm dhe të brendshëm ose denoncimit të mbrojtur publik.

(2) Mbrojtja nga paragrafi (1) i këtij neni sigurohet nga ana e institucionit respektivisht personit juridik ku është kryer denoncimi me ndërmarrjen e veprimit të pengohet shkelja e të drejtave të marrëdhënies së punës ose të cilësdo të drejtë që është e drejtë dhe përmbajtje nga veprimet me të cilat shkelet ose rrezikohet cilado e drejtë e denoncuesit për shkak të denoncimit të kryer.

(3) Nëse nuk është siguruar mbrojtje nga paragrafi (2) i këtij neni, denoncuesi për këtë denoncon në Komisionin Shtetëror për pengimin e Korrupsionit, Avokatin e Popullit të Republikës së Maqedonisë, Këshillin Inspektues, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe te Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë, të cilat sipas denoncimit pa prolongim veprojnë në pajtim me kompetencat e tyre.

(4) E drejta për mbrojtje nga ky nen zgjerohet që ti përfshijë edhe personat të cilët do bëjnë të sigurt se ai që është i denoncuar mund të dyshojë se kanë kryer denoncim kundër tij.

Neni 9

(1) Pas pranimit të denoncimit nga neni 8 paragrafi (3) i këtij ligji, institucionet nga neni 8 paragrafi (3) i këtij ligji, pa prolongim nga institucioni përkatësisht personi juridik ku është bërë denoncimi, kërkon njoftim për ekzistimin e cilësdo formë të shkeljes së të drejtës së denoncuesve dhe të anëtarëve të familjes së tij, për shkak të denoncimit të bërë.

(2) Personi juridik përkatësisht institucioni është i obliguar pa prolongim të veprojë sipas kërkesave nga paragrafi (1) i këtij neni dhe pa prolongim, kurse më së shumti në afat prej tetë ditëve, për këtë të parashtrojë njoftim.

(3) Nëse përcaktohet se institucioni, përkatësisht personi ku është bërë denoncimi ka shkelur të drejtën e denoncuesit, anëtarit të familjes së tij ose personit të afërt me atë, institucionet nga paragrafi (1) i këtij neni pa prolongim u drejtohen institucioneve dhe organeve kompetente me kërkesë me shkrim për ndërmarrje urgjente të masave për mbrojtjen e denoncuesit me ndërprerjen e veprimeve, përkatësisht mënjanimin e lëshimeve me të cilat shkelen të drejtat e denoncuesit.

(4) Për veprimet e ndërmarra dhe konstatimet e caktuara nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, institucionet nga paragrafi (1) i këtij neni pa prolongim e njoftojnë denoncuesin.

(5) Nëse edhe krahas aktivitetit të ndërmarrë të institucioneve nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni vazhdon shkelja e të drejtës së denoncuesit, anëtarit të familjes së vet ose person të afërt me atë, institucionet pa prolongim, kurse më së voni në afat prej 8 ditëve ngrenë iniciativë për ngritjen e procedurës për ndjekje penale, përkatësisht iniciativë për ngritje të procedurës para organeve kompetente për shkarkim, sistemim, ndërrim ose aplikim të masave tjera të përgjegjësisë së personave të zgjedhur ose të emëruar, personave zyrtar ose personave përgjegjës në ndërmarrje publike dhe persona tjerë juridik që disponojnë me kapital shtetëror.

(6) Nëse është denoncuar vepër penale kundër shtetit, kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare, nga sfera e krimit të organizuar dhe për të cilën me Kodin penal është përcaktuar dënim me burg prej së paku katër viteve, dëshmimi i të cilës është shoqëruar me vështirësi joproporcionale ose nuk mund të bëhet pa deklaratë të denoncuesit i cili për shkak të rrezikut potencial që t'i nënshtrohet frikësimit, kërcënimit me hakmarrje ose rrezik për jetën, shëndetin, lirinë, integritetin fizik ose pronës me vëllim më të madh, nuk pajtohet në cilësi të dëshmitarit japë deklaratë, institucionet me pëlqim të siguruar në formë të shkruar nga denoncuesi parashtron:

- në Ministrinë e punëve të brendshme ose Prokurorin publik kompetent iniciativë për parashtrimin e kërkesës me shkrim për parashtrimin e Propozimit për përfshirje në Programin për mbrojtje në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve ose
- te Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë iniciativë për parashtrimin e Propozimit për përfshirje në Programin për mbrojtje në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Mbrojtja gjyqësore

Neni 10

(1) Denoncuesi ka të drejtë për mbrojtje gjyqësore para gjykatës kompetente në pajtim me ligj.

(2) Denoncuesi mund para gjykatës kompetente me padi të kërkojë:

- përcaktim se është ndërmarrë veprim i dëmshëm ose është shkelur e drejta për shkak të denoncimit;
- ndalesë të kryerjes së veprimit të dëmshëm ose shkeljes së të drejtës dhe përsëritjes së veprimit të dëmshëm ose shkeljes së të drejtës;
- anulim me akt me të cilin është kryer veprimi i dëmshëm ose shkelja e të drejtës;
- mënjanim i pasojave të veprimit të dëmshëm ose shkeljes së të drejtës dhe
- kompensim i dëmit material dhe jomaterial;

(3) Procedura për padinë nga paragrafi (2) i këtij neni është urgjente.

(4) Në procedurën për mbrojtje gjyqësore në lidhje me denoncimin lejohet revizion

Ngarkimi i dëshmimit

Neni 11

Në rast të kontestit për ekzistim të shkeljes së të drejtës së denoncuesit dhe të personit të tij të afërt për shkak të denoncimit, ngarkimi i dëshmimit është në anën e institucionit, përkatësisht personit juridik i cili ka shkelur të drejtat e denoncuesit dhe të anëtarëve të familjes së tij.

Pavlefshmëria e dispozitave në marrëveshje dhe akte

Neni 12

Dispozitat në marrëveshjet dhe aktet me të cilat lidhen, përkatësisht rregullohen marrëdhëniet e punës dhe angazhimet e punës, me të cilat ndalohet denoncimi i dyshimit ose kuptimit për vepër të ndëshkueshme ose veprim tjetër të paligjshëm dhe të palejuar me të cilin shkelet ose rrezikohet interesi publik, siguria dhe mbrojtja ose denoncimi i tillë përkufizohet si shkelje e dispozitave për besueshmëri, lojalitet dhe profesionalizëm konsiderohen si të pavlefshme.

Kompensimi i dëmit

Neni 13

(1) Denoncuesi ka të drejtë të kompensimit të dëmit që mund ta pëson ai ose person i afërt me atë për shkak të denoncimit të mbrojtur.

(2) Kërkesa për kompensim të dëmit nga paragrafi (1) i këtij neni realizohet me parashtrimin e padisë në gjykatën kompetente.

Keqpërdorimi i denoncimit të denoncuesit

Neni 14

(1) Keqpërdorimi i denoncimit të denoncuesit është denoncim i vetëdijshëm i informatave të pavërteta për person fizik ose juridik me qëllim të shkaktimit të pasojave të dëmshme për të njëjtin.

(2) Keqpërdorim i denoncimit të denoncuesit është edhe nëse me vëmendje të duhur dhe vetëdije, deri në shkallën që këtë e lejojnë rrethanat, nuk ka kontrolluar nëse ato janë të sakta dhe autentike.

(3) Me përcaktimin e keqpërdorimit nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni humbet mbrojtja e siguruar në pajtim me nenin 8 të këtij ligji.

(4) Keqpërdorimi i denoncimit të denoncuesit për shkak të cilit janë paraqitur pasoja të dëmshme për personin fizik ose juridik është bazë e ngritjes së procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së tij në pajtim me ligj.

Njoftim për denoncime të pranuara nga denoncuesit

Neni 15

(1) Personat e autorizuar përkatësisht udhëheqës të institucioneve përkatësisht personave juridik në sektorin publik te të cilët denoncohet në pajtim me nenet 4 dhe 5 të këtij ligji, janë të obliguar në Komisionin shtetëror për parandalimin e korrupsionit të parashtrojnë raporte gjysmëvjetore për denoncime të pranuara nga denoncuesit.

(2) Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit dhe Ministria e Drejtësisë janë të obliguar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë të parashtrojnë raporte të veçanta vjetore për denoncime të pranuara nga denoncuesit.

(3) Forma dhe përmbajtja e raporteve gjysmëvjetore nga paragrafi (1) i këtij neni rregullohet me aktet e brendshme nga nenet 4 dhe 5 të këtij ligji.

Dispozita kundërvajtëse

Neni 16

Gjobë në shumë prej 3000 deri 6000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit të autorizuar për pranim të denoncimeve nga denoncuesit përkatësisht personit udhëheqës në institucionin përkatësisht personin juridik nëse vepron në kundërshtim me nenin 4 paragrafi (4) i këtij ligji.

Neni 17

(1) Gjobë në shumë prej 2000 deri 4000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet institucionit përkatësisht personit juridik nëse vepron në kundërshtim me nenin 4 paragrafi (7) i këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 30% të gjobës së përllogaritur për institucionin përkatësisht personin juridik do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në institucionin përkatësisht personin juridik për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 18

Gjobë në shumë prej 6000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet institucionit përkatësisht personit juridik nëse vepron në kundërshtim me nenin 5 paragrafi (3) i këtij ligji.

Neni 19

Gjobë në shumë prej 3000 deri 6000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet secilit person i cili do të veprojë në kundërshtim me nenin 7 paragrafi (2) i këtij ligji.

Neni 20

(1) Gjobë në shumë prej 6000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet institucionit përkatësisht personit juridik nëse vepron në kundërshtim me nenin 9 paragrafi (2) i këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 30% të gjobës së llogaritur për institucionin përkatësisht personin juridik do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në institucionin përkatësisht personin juridik për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 21

(1) Gjobë në shumë prej 4000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet institucionit përkatësisht personit juridik nëse vepron në kundërshtim me nenin 15 paragrafi (1) i këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 30% të gjobës së përllogaritur për institucionin përkatësisht personin juridik do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në institucionin përkatësisht personin juridik për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 22

Para ngritjes së kërkesës për ngritjen e procedurës për kundërvajtje do të zbatohet procedurë për barazim në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

Neni 23

Për kundërvajtjet e parapara në këtë ligj procedurë për kundërvajtje do të zbatojë dhe sanksion për kundërvajtje do të shqiptojë gjykata kompetente.

Dispozita kalimtare dhe përfundimtare

Neni 24

(1) Nuk lejohet për përmbajtje të denoncimit nga paragrafi (1) i nenit 3 të këtij ligji të shfrytëzohen materiale të cilat rezultojnë nga përcjellja e paligjshme e komunikimeve nga periudha prej vitit 2008 deri në vitin 2015.

(2) Për person denoncimi i të cilit është me përmbajtje që nuk lejohet në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni nuk sigurohet mbrojtja në pajtim me nenet 8, 9 dhe 10 të këtij ligji dhe nuk aplikohen dispozitat e këtij ligji.

Neni 25

Ministri i Drejtësisë do të miratojë aktet nga neni 4 paragrafi (5) dhe neni 5 paragrafi (4) i këtij ligji në afat prej 60 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 26

Ministri i Drejtësisë do t'i miratojë udhëzimet nga neni 4 paragrafi (8) i këtij ligji në afat prej 60 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 27

Ministri i Drejtësisë do t'i miratojë aktet nga neni 5 paragrafi (4) të këtij ligji në afat prej 60 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 28

Ministri i Drejtësisë do t'i miratojë udhëzimet nga neni 5 paragrafi (7) i këtij ligji në afat prej 60 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 29

Ligjet me të cilat rregullohen të drejtat dhe obligimet e marrëdhënies së punës në sektorin publik dhe privat do të harmonizohen me këtë ligj më së shumti tre muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 30

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", kurse do të fillojë të zbatohet pas katër muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

20180350584

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E DENONCUESVE

Neni 1

Në Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë " numër 195/15), në nenin 1 pas fjalës " denoncimi i mbrojtur", shtohen fjalët: "në sektorin publik dhe privat, për mbrojtjen e interesit publik,".

Neni 2

Në nenin 2 në paragrafin (1) pas fjalës " është denoncimi" shtohen fjalët: "respektivisht zbulimi", kurse pas fjalës "ndëshkueshme" vihet presje dhe shtohen fjala "joetike".

Pas paragrafit (3) shtohen edhe dy paragrafë të rinj (4) dhe (5), si vijon:

"(4) Me nocionin institucion në kuptim të këtij ligji nënkuptohet organ i pushtetit shtetëror dhe lokal, organ tjetër shtetëror i themeluar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe me ligj, agjenci, fond, institucion publik ose ndërmarrje publike e themeluar nga Republika e Maqedonisë ose nga komuna, Qyteti i Shkupit dhe komuna në Qytetin e Shkupit, si dhe institucion tjetër i regjistruar si person juridik me pronësi dominuese ose të plotë të shtetit.

(5) Me nocionin person juridik në kuptim të këtij ligji nënkuptohet person juridik i regjistruar në regjistrin tregtar ose në regjistrin e personave të tjerë juridikë që i udhëheq Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë dhe i cili nuk është përfshirë me nocionin institucion nga paragrafi (4) i këtij neni."

Paragrafët (4) dhe (5) bëhen paragrafë (6) dhe (7).

Neni 3

Në nenin 3 paragrafi (1) fjalët: "me qëllim të mirë dhe me dyshim racional në vërtetësinë e informatave në përmbajtjen e kallëzimit në kohën e denoncimit " zëvendësohen me fjalët: “në mënyrë anonime ose konfidenciale, me qëllim të mirë dhe në bazë të bindjes së arsyeshme në kohën e denoncimit se informatat e përmbajtura në kallëzim janë të sakta“.

Në paragrafin (3) fjalët: "anonimiteti dhe konfidencë, deri në shkallën dhe momentin deri tek ai këtë e kërkon" zëvendësohet me fjalën "konfidencë".

Në paragrafin (4) fjala "anonimitet" zëvendësohet me fjalën "konfidencë".

Neni 4

Në nenin 4 paragrafi (4) në alinenë 2 fjalët: "kërkon të jetë anonim ose denoncon në mënyrë konfidenciale" zëvendësohen me fjalët: “denoncon në mënyrë anonime ose konfidenciale".

Neni 5

Ne nenin 5 paragrafi (3) fjalët: “Organet, institucionet" zëvendësohet me fjalët: “Institucionet" kurse fjalët: "kërkon të jetë anonim ose denoncon në mënyrë konfidenciale" zëvendësohen me fjalët: “denoncon në mënyrë anonime ose konfidenciale"."

Në paragrafin (5) fjalët: “organi të cilit i është dorëzuar informata nuk është kompetent" zëvendësohen me fjalët: “institucioni respektivisht personi juridik tek i cili denoncuesi e ka dorëzuar informatën nuk është kompetent" dhe fjala "kallëzuesi" zëvendësohet me fjalën "denoncuesi".

Në paragrafin (6) fjala "kallëzuesi" zëvendësohet me fjalën " denoncuesi".

Paragrafi (7) ndryshohet si vijon:

"Institucioni respektivisht personi juridik te i cili denoncuesi e ka dorëzuar kallëzimin është i detyruar:

- me kërkesë të denoncuesit t'i japë njoftim për rrjedhën dhe veprimet e ndërmarra në veprimin për kallëzim, si dhe t'i mundësojë denoncuesit këqryje në shkresat e lëndës në pajtim me ligj;

- pas përfundimit të procedurës, ta njoftojë denoncuesin i cili është i njohur për rezultatin e veprimit për kallëzimin, në pajtim me ligjin. "

Paragrafi (8) shlyhet.

Neni 6

Neni 6 ndryshohet dhe vijon:

"(1) Denoncuesi mund të kryejë denoncim të mbrojtur edhe me bërjen e informatave të arritshme publike, nëse:

- denoncimi nga nenet 4 dhe 5 të këtij ligji është bërë i pamundur për shkak të procedurës së pavendosur, respektivisht procedurës për pranimin e kallëzimeve në pajtim me ligjin ose

- denoncuesi në lidhje me kallëzimin e mbrojtur të kryer në pajtim me nenet 4 dhe 5 të këtij ligji, nuk merr informatë për masat e ndërmarra në afatin e caktuar ligjor ose

- nuk janë marrë masa ose ekziston rrezik i identifikuar lehtësisht nga shkatërrimi i provave ose mbulimi i përgjegjësisë (në tekstin e mëposhtëm: denoncim publik i mbrojtur).

(2) denoncuesi i cili kryen denoncim publik të mbrojtur nuk guxon t'i bëjë të arritshme në mënyrë publike:

- të dhënat personale të subjektit që nuk janë relevante për denoncimin e mbrojtur;

- të dhënat, respektivisht informacionet që sipas ligjit, konsiderohen si informata të klasifikuara, në përputhje me rregullat për informatat e klasifikuara, si dhe të dhëna, respektivisht informata me të cilat rrezikohet mbajtja e procedurës penale, kundërvajtëse ose procedurës civile, nëse është e identifikueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe lehtësisht;

- të dhëna respektivisht informata me arritshmërinë publike të të cilave shkelet ose rrezikohet siguria kombëtare, mbrojtja e pavarësisë ose integriteti territorial i Republikës së Maqedonisë.

(3) Denoncuesi i cili do të bëjë kallëzim me bërje publike informacione të arritshme në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni, nuk ka të drejtën e mbrojtjes që sigurohet në pajtim me dispozitat e neneve 8, 9 dhe 10 të këtij ligji."

Neni 7

Në nenin 7 paragrafi (1) pas fjalës "denoncuesi" shtohen fjalët: "pa pëlqimin e tij" dhe pas fjalës "vendim" shtohen fjalët: "kur është e domosdoshme për mbajtje të procedurës para organit kompetent".

Në paragrafin (2) të këtij neni fjalët: "kallëzuesi" në rreshtin e dytë dhe të katërt zëvendësohen me fjalën "denoncuesi".

Paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

"Personi i autorizuar për pranimin e kallëzimeve nga denoncuesi detyrohet, gjatë pranimit të informacioneve, ta njoftojë denoncuesin se identiteti i tij mund të zbulohet nga organi kompetent në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, si dhe ta njoftojë atë për masat për mbrojtjen e pjesëmarrësit në procedurën penale.".

Paragrafi (5) ndryshohet dhe vijon:

"Për zbulimin e identitetit të denoncuesit në bazë të vendimit gjyqësor të miratuar në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, personi i autorizuar për pranim të kallëzimeve nga denoncuesit është i detyruar ta njoftojë denoncuesin përpara zbulimit të identitetit.".

Neni 8

Në nenin 8 paragrafi (1) pas fjalës "drejtë" vendoset presje dhe shtohen fjalët: “gjatë përcaktimit të përgjegjësisë, sanksion, ndërprerje e marrëdhënies së punës, suspendim i vendit të punës, sistemim në vend pune tjetër që është më pak i volitshëm, diskriminim".

Neni 9

Në nenin 10 paragrafi (2) në alinenë 1 fjala "denoncim" zëvendësohet me fjalët: “denoncim të mbrojtur".

Në alinetë 2, 3 dhe 4 pas fjalëve: “shkelje e së drejtës", shtohen fjalët: “për denoncim të mbrojtur".

Në alinenë 5 pas fjalës "dëm" shtohen fjalët: “për denoncim të mbrojtur".

Neni 10

Në nenin 15 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit është i detyruar të paraqesë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë raport vjetor për kallëzimet e pranuara nga denoncuesit në suaza të raportit të vet vjetor për punë.".

Neni 11

Pas nenit 15 shtohen titull i ri dhe nen i ri 15-a, si vijon:

"Mbikëqyrje mbi zbatimin e ligjit

Neni 15-a

Mbikëqyrje mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji kryen Ministria e Drejtësisë."

Neni 12

Neni 28 shlyhet.

Neni 13

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

20202573302

L I GJ
I NDRYSHIMIT TË LIGJIT TË MBROJTJES SË DENONCUESVE

Neni 1

Në Ligjin e Mbrojtjes së Denoncuesve („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 196/15 dhe 35/18), në nenin 16 fjalët: „prej 3.000 deri 6.000 euro" zëvendësohen me fjalët: „prej 100 deri 500 euro", ndërkaq shlyhet nyja „i".

Neni 2

Në nenin 17 ndryshohet paragrafi (1) siç vijon:

„(1) Mikrotregtarit me 10 persona të punësuar do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 250 deri 500 euro, në kundërvlerë denari; përkatësisht tregtarit të vogël ose institucionit me 10 persona të punësuar do t'i shqiptohet gjobë prej 500 deri 1.000 euro, në kundërvlerë denari; përkatësisht tregtarit të mesëm ose institucionit me 10 deri 50 persona të punësuar do t'i shqiptohet gjobë prej 750 deri 1.500 euro, në kundërvlerë denari, përkatësisht tregtarit të madh ose institucionit me më shumë se 50 persona të punësuar do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 1.000 deri 2.000 euro në kundërvlerë denari, nëse vepron në kundërshtim me nenin 4 paragrafi (7) të këtij ligji.".

Në paragrafin (2) fjalët: „30% nga gjoba e përcaktuar për institucionin, përkatësisht personin juridik" zëvendësohen me fjalët: „250 deri 500 euro në kundërvlerë denari".

Neni 3

Në nenin 18 fjalët: „prej 6.000 euro" zëvendësohen me fjalët: „prej 5.000 deri 10.000 euro", ndërkaq shlyhet nyja „i".

Neni 4

Neni 19 ndryshohet siç vijon:

„(1) Personit të autorizuar për pranimin e kallëzimeve të denoncuesve ose personit tjetër zyrtar do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 500 euro, në kundërvlerë denari, nëse vepron në kundërshtim me nenin 7 paragrafi (2) ose (3) të këtij ligji.

(2) Personit fizik që nuk është person zyrtar do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 250 euro, në kundërvlerë denari, nëse vepron në kundërshtim me nenin 7 paragrafi (3) të këtij ligji.

(3) edhe mikrotregtarit me 10 persona të punësuar do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 1.000 euro, në kundërvlerë denari; përkatësisht tregtarit të vogël ose institucionit me 10 persona të punësuar do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 2.000 euro në kundërvlerë denari; përkatësisht tregtarit të mesëm ose institucionit me 10 deri 50 persona të punësuar do t'i shqiptohet gjobë prej 6.000 euro në kundërvlerë denari; përkatësisht tregtarit të madh ose institucionit me më shumë se 50 persona të punësuar do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 10.000 euro në kundërvlerë denari, për kundërvajtje sipas paragrafit (1) të këtij neni.".

Neni 5

Në nenin 20 ndryshohet paragrafi (1) siç vijon:

„(1) Mikrotregtarit me 10 persona të punësuar do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro, në kundërvlerë denari; përkatësisht tregtarit të vogël ose institucionit me 10 persona të punësuar do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 1.000 deri 2.000 euro, në kundërvlerë denari; përkatësisht tregtarit të mesëm ose institucionit me 10 deri 50 persona të punësuar do t'i shqiptohet gjobë prej 3.000 deri 6.000 euro, në kundërvlerë denari; përkatësisht tregtarit të madh ose institucionit me më shumë se 50 persona të punësuar do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 5.000 deri në 10.000 euro, në kundërvlerë denari, nëse vepron në kundërshtim me nenin 9 paragrafi (2) të këtij ligji.".

Në paragrafin (2) fjalët: „30% nga gjoba e përcaktuar për institucionin, përkatësisht personin juridik" zëvendësohen me fjalët: „500 euro në kundërvlerë denari".

Neni 6

Në nenin 21 paragrafi (1), pas fjalëve: „shumë prej" shtohen fjalët: „1.000 deri", ndërkaq shlyhet nyja „i".

Në paragrafin (2) fjalët: „30% nga gjoba e përcaktuar për institucionin, përkatësisht personin juridik" zëvendësohen me fjalët: „500 euro në kundërvlerë denari".

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë pas botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".